



REPUBLIKA E KOSOVËS REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD CIVIL SERVICE OF KOSOVO



Pranimi / Dorezimi Prilipi / Prilipi Receipt / Delivery	28 . 10 2022	2	viti god year
Organ / Njësia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot H / Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SK/MS/HEK	6556 / 2022		1.3



Republika e Kosovës Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.810/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës–Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave i përbërë nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Ilire Mehmeti-Shaqiri-Zyrtare e Lartë për Bashkëpunim Profesional, në cilësinë e procesmbajtëses, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.810/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga _____ të cilën me autorizim e përfaqëson avokat _____ kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Brendshme, në çështjen juridike “kompensim material”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1, nenin 16 paragrafi 3 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, të mbajtur më datën 28.10.2022, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e pa lejuar ankesa me numër A.nr.810/2022 e datës 21.09.2022 e parashtruar nga ankuesja _____

A r s y e t i m

Ankuesja _____ tani e pensionuar, me datë 21.09.2022 ka parashtruar ankesë me numër protokoli 54/2022 në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Përgjigjes me numër 466 të datës 11.06.2022 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendim ankimor që t’i njihet e drejta e kompensimit të tri (3) pagave jubilarë, tri (3) pagave mujore përcjellës dhe shpenzimet e ushqimit për ditët e pranisë në punë duke u bazuar në Marrëveshjen Kolektive.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave, me datë 23.09.2022 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë në Ministrinë e Punëve të Brendshme. Ndërsa Këshilli me datë 04.10.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë së bashku me provat lidhur me çështjen ankimore në vendosje.

Kolegj për Shqyrtimin e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, si dhe vendosjes në mënyrë meritore të çështjes, ka administruar këto prova: Ankesën me numër të

protokollit 5541/2022 të datës 21.09.2022 të parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës; Vendimin e Udhëheqësit të Zyrës së Pensioneve lidhur me miratimin e njohjes së drejtës në Kategorizim për Pensione; Monitorimin e transaksioneve të llogarisë të datë 17.05.2019; Përgjigjen në kërkesë me numër 466 të datës 11.06.2021; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër të protokollit 5650/2022 të datës 23.09.2022; Përgjigjen në kërkesë me numër të protokollit 5843/2022 të datës 04.10.2022; Akt emërimit me shenjën DRAPSH/ARC-15/13 të datës 31.01.2013; Vendimin me numër 02-5703 të datës 04.12.2018 për pensionim të nëpunëses civile; Listën pagave për muajin 01.12.2018 deri me datën 31.12.2018; Dëshminë lidhur me kompensimin e një page përcjellëse pas pensionimit (lista e pagave dt. 01.12.2018 deri më 31.12.2018); Dëshminë lidhur me kompensimin e pagës jubilarë lidhur me 10 vite përvojë punë, (listën e pagave të datës 01.12.2013 deri më datën 31.12.2013); Kërkesën me numër 431 të datës 09.06.2021 drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme; Autorizimin e datës 02.06.2021; Vërtetimin me numër 812/18 të datës 08.11.2018 të Menaxheres së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme; e-maili me numër protokollit 6520/2022 i datës 28.10.2022 nga përfaqësuesi i autorizuar i ankesës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses *është parashtruar jashtë afatit ligjor, sepse:*

Bazuar në shkresat e lëndës, Kolegji ka gjetur se ankuesja ka qenë e punësuar në Agjencinë e Regjistrimit Civil (tutje ACR)-Departamenti për Regjistrimin e Automjeteve dhe Patentë-Shoferëve, në pozitën e punës *Nëpunëse administrative për patentë shoferë*, në zyrën në Gjakovë. Të njëjtës përmes Vendimit me numër protokollit 5703 të datës 04.12.2018 të Drejtorit të Përgjithshëm të ARC-së i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të moshës së pensionimit, duke iu njohur kompensimi i një page në shumën e pagës së njëhershme në vlerën e pagës së fundit. Tutje ankuesja me datën 09.06.2021 përmes përfaqësuesit me autorizim ka parashtruar kërkesë të organi i punësimit gjegjësisht Ministria e Punëve të Brendshme lidhur me kompensimin e shpenzimeve të ushqimit, tri pagave përcjellëse me rastin e pensionimit si dhe të drejtat e shpërblimit jubilar. Ndërsa kjo e fundit, përmes përgjigjes me numër protokollit 466 të datës 11.06.2021, ka sqaruar së Ministria e Punëve të Brendshme sipas legjislacionit në fuqi ka kryer obligimin ligjor ndaj ankueses, duke e i bërë kompensimin e pagës jubilarë në vlerën 82.00 euro me datën 01.12.2013 si dhe një pagë shtesë në shumën prej një page mujore në vlerën e pagës së fundit me rastin e pensionimit. Ndërsa ankuesja me datë 21.09.2022 parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës kundër përgjigjes me numër protokollit 466 të datës 11.06.2021 me pretendimin ankimor së bazuar në Marrëveshjen Kolektive ankueses i takojnë shpenzimet e ushqimit në vendin e punës, tri paga jubilarë dhe tri paga mujore që i ka marrë në ter muajt e fusnit. Kërkon që Këshillit të aprovoj ankesën si të bazuar, si dhe të obligoj Ministrinë e Punëve të Brendshme që ankueses t'i kompensoj tri paga jubilarë për përvojën tridhjetë vjeçare në shumë prej 1.213.53 euro, tri paga mujore me rastin e pensionimit në shumë prej 1.213.53 euro, shuma e përgjithshme 2.427,06 euro, si dhe të paguaj shpenzimet e ushqimit nga data 01.01.2015 deri në pensionimin e ankueses me datë 04.12.2018 në shumë prej 2 euro për cdo ditë të pranisë në punë.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga



marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa lidhur me pranueshmerinë e ankesës me dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht neni 127 paragrafi 1 është përcaktuar se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.* Andaj, në kuptim të këtyre dispozitave ligjore si dhe meqenëse ankuesja përgjigjen e organit të punësimit me numër protokoll 466 të datës 11.06.2021 të cilën e atakon me ankesë, e ka pranuar me datë 16.06.2021, datë kjo e konfirmuar nga përfaqësuesi me autorizim i ankueses përmes emailit të datës 28.10.2022, Kolegji konstaton se ankesa A.nr.810/2022 e parashtruar nga ankuesja në Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 21.09.2022, është ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, rrjedhimisht afati i ankesës ka filluar të rrjedhë nga data e pranimit të përgjigjes me data 16.06.2021, ndërsa ankuesja parashtron ankesë me datë 21.09.2022, pra pas një viti.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi*

KËSHILLI I PAVARUR MBIQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.810/2020

Ilire Mehmeti-Shaqiri

[Signature]
Proçesmbajtëse

Ardita Haxhnikaj-Demi

[Signature]
Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankueses
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Brendshme;
- Arkivit të KPMSHCK-së

